

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo	PRISHTINA 
	Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	01-528

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22, dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010 dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-44226/20 dt.24.02.2020, të aplikuesit/pronarit **Maliq Mehmeti**, rr. Rustem Statovci, nr.12, Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e ndërtesës individuale banimore / shtëpisë familjare, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 15.06.2020, merr këtë:

V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I Caktohen kushtet ndërtimore aplikuesit/pronarit **Maliq Mehmeti**, nga Prishtina, sipas kërkesës 05 nr. 350/02-44226/20 dt.24.02.2020, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e ndërtesës individuale banimore / shtëpisë familjare, me etazhitet P+2, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1673-0 ZK. Matëçan.

II. Lokacioni / parcela kadastrale e lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, i miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 035-181427 dt. 24.09.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “ndërtim individual”.

Për parametrat, kriteret urbane dhe kushtet e ndërtimit sipas PZHU-së, kërkuksi është informuar përmes "Informim nga Plani Zhvillimor Urban - PZHU", me referencë nr. 2575 dt. 03.12.2019, lëshuar përmes sistemit online nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, bashkëpronarët dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
- Nr. 1673-0 ZK. Matëçan;.....S=438m²;..... Maliq Mehmeti.....”Arë e klasës 4”;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale të lartcekur nuk ka ndërtime ekzistuese, gjegjësisht parcela është e zbrazët;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni është relativisht i pjerrët me disnivel ~ 3m’, drejtimi jugperëndim-verilindje;
- Qasja ekzistuese e parcelës kadastrale të lartcekur, bëhet përmes rrugës lokale “Sadik Bega”;
- Në kuadër të perimetrit prej 50m’ të parcelës kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa individuale banimore.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin - ndërtimin e ndërtesës individuale banimore / shtëpisë familjare, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi dhe qasja në parcelë, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelës, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit – “Situacioni i ngushtë”, bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Destinimi i shfrytëzimit, sipas Planit Zhvillimor Urban, është “ndërtim individual”;
- Parcela kadastrale e trajtuar për realizimin e ndërtesës individuale banimore / shtëpi familjare, konkretisht parcela kadastrale e përfshirë- e trajtuar brenda vijës rregulluese, është:
 - nr. 1673-0, me $S=325m^2$;
 - Sipërfaqe totale $S=438m^2$;
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1673-0 ZK. Matiçan, planifikohet ndërtimi i ndërtesës individuale banimore / shtëpisë familjare, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas llogarive dhe projektit konceptual, si në vijim:
 - $S=242.59 m^2 / 247.48m^2$ mbi tokë dhe $0.0 m^2$ nën tokë /
 - Etazhitet: **P+2**
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës individuale banimore / shtëpisë familjare, të jetë për banim familjar dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo dhe hapësira garazhesh etj. (sipas projekt propozimit);
- Etazhiteti i ndërtesës individuale banimore / shtëpisë familjare, sipas Planit Zhvillimor Urban është max. I ÷ III etazhe, e propozuar dhe e miratuar P+2;
- Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP), sipas Planit Zhvillimor Urban është max. 0.2-0.3 (20-30%) e sipërfaqes së parcelës.
Ndërtesë individuale banimore / shtëpi familjare:
 $S=325 \times 0.3=97.50m^2$ / lejuar sipas PZHU-së /,
 $S=86.75m^2$; / sipas projekt propozimit /.
- Indeksi i shfrytëzimit të nëntokës (ISHPN), është max. 0.60, bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës.
Ndërtesë individuale banimore / shtëpi familjare:
 $S=325 \times 0.6=195.0m^2$ / lejuar sipas vendimit/
 $S=0.0m^2$; /sipas projekt propozimit /.
- Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit (ISG), sipas pikës 2, paragrafi II. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01-031-185481 dt. 14.08.2015, sipërfaqja e gjelbëruar e parcelës, e përcaktuar në bazë të Indeksit të Sipërfaqes së Gjelbëruar, duhet të jetë së paku 40%, përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, kjo sipërfaqe mund të jetë së paku 30%;
Ndërtesë individuale banimore / shtëpi familjare:
 $S=325 \times 0.4=130.00m^2$ / lejuar sipas vendimit/
 $S=198.31m^2$; /sipas projekt propozimit /.
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN), sipas PZHU-së, është 0.6- 0.8 (60%- 80%).Koeficienti ndërtimor i parcelës kadastrale brenda vijës rregulluese- parcelës ndërtimore, do të llogaritet si në vijim: 100% për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , 50% për etazhet me vëllim mbi 51% mbi tokë- suteran, dhe 0% për etazhet e nëntokës- bodrume.
Ndërtesë individuale banimore / shtëpi familjare:
 $S=325 \times 0.8(80\%)=260.00m^2$ / lejuar sipas PZHU-së /,
 $S=242.59m^2$; / sipas projekt propozimit për etazhitetin P+2/.
- Ngritja e nivelit të përdhese nga niveli i terrenit, të jetë max. 0.45m’;
- Qasja në parcelë të jetë nga rruga lokale “Sadik Bega”, në bazë të projektit propozimit të prezantuar;
- Bazuar në kriteret e PZHU-së, distanca minimale në mes dy ndërtesave është 1H (aty ku ka hapje të kthinave primare), kurse distanca minimale nga kufiri i parcelës kadastrale fqinje është 0.5H. Te fasadat anësore, ku ka kthina sekondare, si: banjo, wc, depo, shkallë dhe garazhe, me marrëveshje të fqinjëve, kjo distancë mund të jetë 0;
- Bazuar në kriteret e Planit Zhvillimor Urban, distanca minimale e ndërtesave-vija ndërtimore nga bordurat e rrugëve – rrugët e qytetit do të jenë:
 - jo më pak se 5m’ për rrugë me gjerësi deri në 7m’;

- jo më pak se 7.5m' për rrugët me gjerësi 7÷15m';
- jo më pak se 10m' për rrugët me gjerësi mbi 15m';
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2015 dhe protokoluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Për shtëpitë individuale të banimit, duhet të sigurohet 1 vendparkim, për një njësi banimi; Parkimi i jashtëm mund të planifikohet brenda vijës rregulluese duke mos e tejkaluar kushtin prej 40% për gjelbërim, sipas Vendimit të kryetarit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-185481 dt. 14.08.2015;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.

V. **Kyçja në infrastrukturë** - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçe në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçe nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VI. **Dokumentacioni ndërtimor** - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhesë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhesë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";

- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme;

VII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me bashkëpronarët/investitorët. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

VIII. Paga e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcela kadastrale nr. 1673-0 ZK. Matëcan, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit “Arë e klasës 4”, me sipërfaqe totale $S=438 \text{ m}^2$, kërkohet që paraprakisht të bëhet paga e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit – “Situacioni i ngjyshit”, dhe parcelës ndërtimore të caktuar me Planin Zhvillimor Urban, e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore në sipërfaqe prej $S=438 \text{ m}^2$. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

IX. Paga e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Paga e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

X. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Aplikuesi/pronari **Maliq Mehmeti**, nga Prishtina, me kërkesën 05 nr. 350/02-44226/20 dt. 24.02.2020, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e ndërtesës



individuale banimore / shtëpisë familjare, me etazhitet P+2, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.
Me kërkesë, 05 nr. 350/02-44226/20 dt.24.02.2020, "Plotësim Lënde" 05 nr.350/02-44226/20/1 dt. 19.03.2020, "Plotësim Lënde" 05 nr.350/02-44226/20/1 dt. 24.04.2020, "Plotësim Lënde" 05 nr.350/02-44226/20/2 dt. 29.05.2020, "Plotësim Lënde" 05 nr.350/02-44226/20/3 dt. 02.06.2020, dhe "Plot. Lënde" 05 nr.350/02-44226/20/4 dt. 08.06.2020, dhe gjatë fazës së trajtimit është prezantuar dhe trajtuar dokumentacioni:

- *Certifikatën e njësisë kadastrale nr. P-71914050-00320-5, P-71914050-00320-4, P-71914050-00320-7, P-71914050-00320-8, dhe P-71914050-01673-0, ZK Matiçan dhe P-71914059-06348-1, P-71914059-07083-0 ZK Prishtinë, dhe kopja e planit nr. 320-5, 320-7, 320-8, 320-4 dhe 1673-0, ZK. Matiçan ;*
- *Vërtetimi mbi obligimet tatimore, në emër të Maliq Mehmeti, nr. 43919/20 dt. 24.02.2020;*
- *Kopje të dokumentit të identifikimit të Maliq Mehmeti, Nexhmi Uka dhe Eljesi Surdulli;*
- *Shkresën "Informim nga Plani Zhvillimor Urban - PZHU", me referencë 2575 dt.01.12.2019, të lëshuar me dt. 03.12.2019 nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm - Prishtinë;*
- *Akti noterial "Pëlqim", pronari i parcelës nr. 00320-6, ZK Matiçan, Nexhmi Uka, dhënë Maliq Mehmeti pëlqimin për lejimin që të ndërtohet në afërsi në 1m deri në 1.5 metër largësi nga parcela e tij, i përpiluar te notere Sevdije S. Krasniqi në Prishtinë, LRP.Nr. 14791/2019, dt. 16.12.2019;*
- *Akti noterial "Autorizim", e lidhur në mes të pronarit Maliq Mehmeti nga Prishtina, dhënë Eljesi Surdulli nga Prishtina, për përfaqësim pranë Organeve Kompetente Administrative, Shërbimeve Komunale (KEDS, Ujësjiellës, etj.), Komunë, Kadastrale dhe Zyrave Noteriale,, i përpiluar te notere Sevdije S. Krasniqi në Prishtinë, LRP.Nr. 14163/2019, dt. 29.11.2019;*
- *Incizimi gjeodezik për parcelën kadastrale nr. 320-5 dhe 320-8 ZK. Matiçan, i punuar nga gjeodeti i licencuar Arbnor Zeqiri me nr. të licensës 179, dt. 25.11.2019;*
- *Manuali gjeodezik për parcelën kadastrale nr. 1673-0 ZK. Matiçan, i punuar nga gjeodeti i licencuar Arbnor Zeqiri me nr. të licensës 179, dt e rlevimit 23.04.2020;*
- *Projektin konceptual të punuar nga kompania "Sagal" sh.p.k, me nr. të certifikatës së regjistrimit të biznesit 810845993;*
- *Fotot e lokacionit.*

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurën e shqyrtimit të kërkesës 05 nr. 350/02-44226/20 dt.24.02.2020, dokumentacionit dhe provave të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për zonën në fjalë dhe rregullativës ligjore në fuqi, me shkresën zyrtare "Plotësim dokumentacioni" 05 nr. 350/02-44226/20 dt. 11.03.2020, për vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës, është kërkuar plotësimi i lëndës me dokumentacionin si në vijim:

- *Të prezantohet origjinali ose kopja e vërtetuar e Certifikatës së njësisë kadastrale nr. P-71914050-00320-4, ZK Matiçan dhe kopja e planit nr. 320-4, ZK. Matiçan;*
- *Të prezantohet kopja e vërtetuar e aktit noterial "Autorizim", e lidhur në mes të pronarit Maliq Mehmeti nga Prishtina, dhënë Eljesi Surdulli nga Prishtina, për përfaqësim pranë Organeve Kompetente Administrative, Shërbimeve Komunale (KEDS, Ujësjiellës, etj.), Komunë, Kadastrale dhe Zyrave Noteriale,, i përpiluar te notere Sevdije S. Krasniqi në Prishtinë, LRP.Nr. 14163/2019, dt. 29.11.2019;*
- *Të prezantohet manuali gjeodezik i bashkimit të parcelave në sistemin koordinativ shtetëror Kosova Ref.0, me vijën rregulluese dhe ndërtimore, nga kompania e licencuar gjeodezike;*
- *Të përmirësohet projekti konceptual/projekt propozimi i prezantuar:*
 - *Të respektohet distanca e përcaktuar sipas aktit noterial "Pëlqim", pronari i parcelës nr. 00320-6, ZK Matiçan, Nexhmi Uka, dhënë Maliq Mehmeti pëlqimin për lejimin që të ndërtohet në afërsi në 1m deri në 1.5 metër largësi nga parcela e tij, i përpiluar te notere Sevdije S. Krasniqi në Prishtinë, LRP.Nr. 14791/2019, dt. 16.12.2019;*
 - *Megjithatë parcela fqinje nr. 320-7, ZK. Matiçan, është i po i njëjtit pronar, Maliq Mehmeti, atëherë i lejohet që të ndërtohet në afërsi deri aty ku zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe*

të ekzekutohet në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore;

– Respektimi i distancave për hapje-dritare me parcelën fqinje, konkretisht me parcelën nr. 320-7, ZK. Matëan, gjegjësisht të mos ketë hapje të dritareve në kthinat primare (qëndrim ditor, kuzhinë, tryezari, dhoma), në distanca minimale sipas normativave të parapara me PZHU;

– Të prezantohet në situacion, qasja në parcelë nga rruga;

– Mbrenda vijës rregulluese, të respektohen kriteret e parapara me Planin Zhvillimor Urban, në veçanti ISHP dhe ISPN;

– Mbrenda vijës rregulluese, të respektohet koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese (ISHGJ), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, sipas Vendimit të kryetarit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-185481 dt. 14.08.2015, është min 40%, përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, kjo sipërfaqe mund të jetë së paku 30%;

– Të përmirësohet prezantimi grafik i projektit, duke prezantuar dimensionimet e distancave me parcelat fqinje, si dhe të prezantohet pjesa tekstuale.

Aplikuesi/pronari Maliq Mehmeti, me shkresat zyrtare ““Plotësim Lënde” 05 nr.350/02-44226/20/1 dt. 19.03.2020, “Plotësim Lënde” 05 nr.350/02-44226/20/1 dt. 24.04.2020, “Plotësim Lënde” 05 nr.350/02-44226/20/2 dt. 29.05.2020, “Plotësim Lënde” 05 nr.350/02-44226/20/3 dt. 02.06.2020, dhe “Plot. Lënde” 05 nr.350/02-44226/20/4 dt. 08.06.2020, i është drejtuar kësaj drejtori duke prezantuar: origjinalin e aktit noterial “Autorizim”, Çertifikatën e njësisë kadastrale nr. P-71914050-00320-7, dhe P-71914050-01673-0 ZK Matëan, dhe kopja e planit nr. 320-7, dhe 1673-0 ZK Matëan, manuali gjeodezik për parcelën kadastrale nr. 1673-0 ZK. Matëan dhe projektin e ri konceptual, me ndryshimet e kërkuara sipas shkresës zyrtare 05 Nr.350/02-44226/20 dt. 11.03.2020.

Drejtoria e Urbanizmit, në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për kushte ndërtimore 05 nr. 350/02-44226/20 dt.24.02.2020, “Plotësim Lënde” 05 nr.350/02-44226/20/1 dt. 19.03.2020, “Plotësim Lënde” 05 nr.350/02-44226/20/1 dt. 24.04.2020, “Plotësim Lënde” 05 nr.350/02-44226/20/2 dt. 29.05.2020, dhe , “Plotësim Lënde” 05 nr.350/02-44226/20/3 dt. 02.06.2020, dokumentacionit dhe provave të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për hapësirën ku gjendet lokacioni-PZHU-në, rregullativën ligjore nga lëmi i ndërtimit, planifikimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe konsultimin e projekt propozimit – Projektit konceptual të ndërtesës Plani i situacionit -"Situacioni i ngushtë", të prezantuar, në mënyrë kronologjike ka konstatuar se:

Kjo drejtori pas pranimi të kërkesës, shqyrtimit të sajë me dokumentacionin e prezantuar, dhe konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për ndërtim Nr.04/L -110 dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr.06/2017 dt.23.05.2017, me datë 15.08.2019 ka vendosë shkresën “Njoftim publik” për njoftimin dhe mundësin e dhënien së komenteve të pronarëve dhe poseduesve të rrethinës në diametrin e dritës prej 50m’ nga parcela ku synohet të ndërtohet, i cili njoftim ka qëndruar pesë (5) ditë në lokacionin në fjalë, nga data 15.05.2020 deri me datë 19.05.2020, gjatë së cilës periudhë nuk kanë arritur komente në E-mail adresat e vendosura në njoftimin publik;

Sipas projekt propozimit të prezantuar, në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1673-0 ZK. Matëan (bashkim i parcelave nr. 320-5 dhe 320-8, ZK Matëan), është planifikuar të ndërtohet ndërtesa individuale banimore / shtëpi familjare, me etazhitet P+2, sipas parametrave dhe kriterëve të përcaktuara në PZHU dhe normat e planifikimit, kurse për pozicionimin e ndërtesës në afërsi të parcelës kadastrale fqinje, me nr. 00320-6, ZK Matëan, aplikuesi ka prezantuar aktin noterial “Pëlqim” nga pronari i saj, përpiluar te notere Sevdije S. Krasniqi në Prishtinë, LRP.Nr. 14163/2019, dt. 29.11.2019, kurse për pozicionimin e ndërtesës në afërsi të parcelës kadastrale fqinje, me nr. 00320-7, ZK Matëan, aplikuesi ka prezantuar certifikatën e njësisë kadastrale, në të cilën është pronar po i njëjti, Maliq Mehmeti.

Në bazë të projektit propozimit të prezantuar, qasja në parcelë bëhet nga rruga lokale “Sadik Bega”;

Pas prezantimit të zgjidhjes urbane, është bërë kontrollimi i rrugëve të prezantuara brenda zgjidhjes urbane – projektit të lokacionit të prezantuar, nga zyrtari përgjegjës për komunikacion i kësaj drejtori, me ç ‘rast i njëjti ka konstatuar si në vijim:

“Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Maliq Mehmeti, në Matiçan, Prishtinë, lidhur me kërkesën e kushteve ndërtimore të lëndës 05-350/02-44226/20 dt.24.02.2020, kyçja për automjete në rrugën ekzistuese “Sadik Bega”, e cila rrugë është e paraparë edhe me planin zhvillimor urban, sipas prezantimit në situacion për ndërtesën banimore - shtëpi individuale me etazhitet P+2, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e tillë. Kyçja duhet ti përshtatet teknikisht rrugës dhe të aplikohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes.”

Andaj si konkludim përfundimtar, pas konstatimeve të lartë shënuara, dokumentacionin e prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni (Planit Zhvillimor Urban), rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, projektit konceptual, dhe me që gjatë procedurës së njoftimit publik nuk është pranuar ndonjë ankesë apo sygjerim, ka konstatuar se, kërkuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret e Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacionit -"Situacioni i ngushtë", me vijën ndërtimore dhe vijën rregulluese si dhe manualin gjeodezik për parcelën kadastrale nr. 1673-0 ZK. Matiçan, të punuar nga gjeodeti i licencuar Arbnor Zeqiri, me nr. Lic. 179, dt e rilevimit 23.04.2020.


Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror- MEA.

Ky Vendim është përpiluar në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesëve, në dosje të lëndës 05 nr. 350/02-44226/20 dt.24.02.2020, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me Qytetarë.

Përmes postës elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave ,Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.


**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-44226/20 DT. 15.06.2020**

Zyrtare,
Ermira Muçiqi



U.D. Udhëheqëse e Sektorit
Mimoza Berisha Prestreshi





Studio Projektuese

SAGAL

Studio Krijimi dhe Ndermjetesimi

ULPIANE C12 H8 Nr 13, Prishtine

Investitori:

Maliq Mehmeti

Matiqan, ngastrat 00320-5 dhe 00320-8
Prishtine
Kosove

Emri i vizatimit

Situacioni i ngushte

Statusi i vizatimit

Projekt Ideor
shtëpi banimi individual
P+2

Vizatuar nga:

z. Varis Mehmeti

Kontrolluar nga:

z. Eljesi Osman Surdulli

Data: Qershor 2020

Data: Qershor 2020

Perpjese

SAGAL

Nr i Fletes

A.01.3 F-A3

1:200

Revidimi nr.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 16730

Zona kadastrale / Katastarska zona: Matiçan Numri i lëndës / Broj predmeta: 21K-2020

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 200

Koordinatat e pikave		
Nr.Pikes	Y	X
1	7515740.740	4722736.970
2	7515739.590	4722727.570
3	7515738.600	4722718.560
4	7515745.900	4722716.210
5	7515746.920	4722725.660
6	7515747.980	4722734.420
7	7515747.336	4722729.097
8	7515753.502	4722725.808
9	7515758.242	4722723.226




Rilevoi / Snimio: Arbnor Zeqiri
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 179

Nënshkrimi / Potpis: [Signature]

Data e rilevimit / Datum snimanja: 23.04.2020



Aprovoi / Usvojio: _____
(emri dhe mbiemri i përsërit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____